



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:257852

Datë: 07.11.2024

Numri i dokumentit: 06421452

C.nr.962/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtar Shemsedin Haxhiaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.Mnga fshati B., komuna Istog, të cilën e përfaqëson Fatmir Kurmehaj avokat nga Pejë, rruga “Shpetim Bojku”, kundër të paditurës Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, baza e kontestit: kompensim të diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,000.00 euro jashtë seance gjyqësore me datë 28.10.2024 bie këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e A.**MDETYROHET** e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguajë paditëses **A.M** në emër të kompensim të diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit– licensimit prej 27 % të pagës bazë 1385.10 euro për periudhën prej 01.01.2021 deri me 06.02.2023 me kamat ligjore prej 8 % nga data 21.11.2023 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga pranimit i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 125 euro të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarës të tyre, me datë 21.11.2023, ka paraqitur padi, kundër të paditurës për Kompensim mbi bazën e kualifikimit-licensimit si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 02.05.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 07.05.2024, (e cila është konfirmuar përmes fletë ktheses, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t’i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadija nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë për paditësin **A.M** del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kontrata me numër 737/19 datës 27.03.2019, Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit–Prishtinë–Bachelor i Gjeografi dhe edukata qytetare, listës së pagës, Licenca e mësimdhënësit me numër 1026639.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 21.11.2023), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive te detyrimit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 104 € për përpilim padisë dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 21 €, apo në shumë të përgjithshme prej 125 €.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i’u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c te LPK-së, dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 e datës 29.08.2008, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
C.nr.962/23, datë 28.10.2024

GJYQTARI
Shemsedin Haxhijaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.